



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obština-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "Euro Construction NNP shpk" të datës 15.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve në lagjen Taslixhe" me nr. të prokurimit 616-25-7068-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e OE "Euro Construction NNP shpk" të datës 15.10.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve në lagjen Taslixhe" me nr. të prokurimit 616-25-7068-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "Euro Construction NNP shpk" (tutje "parashtruesi") me datë 15.10.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i rrugëve në lagjen Taslixhe" me nr. të prokurimit 616-25-7068-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit: "Ky formulim është i qartë: nuk kërkon kontrata të mbyllura, por dëshmi të kryerjes së punimeve pra, dokumente që provojnë se punët janë realizuar dhe pranuar nga mbikëqyrësi apo autoriteti përkatës. Qëllimi i kësaj kërkesë është të vërtetojë kapacitetin real dhe performancën teknike të operatorit, dhe jo të përjashtojë projektet e hapura që vërtetojnë përvojë aktive dhe të dokumentuar".

Lidhur me pretendimet duhet cekur se KRPP me datë 22.11.2022 ka publikuar interpretimin nr. 10 ku ndër të tjera ka potencuar si vijon: "Listën e kontratave të realizuara në tri vitet e fundit, (nga data e njoftimit për kontratë) kjo do të thotë që kontratat e kërkuara nga AK, duhet të jenë të realizuara (jo në realizim e sipër) pra të përfunduara brenda tri viteve të shkuara nga data e njoftimit për kontratë". Në rastin konkret as vet parashtruesi nuk e konteston faktin që kontratat e prezantuara nga parashtruesi në listën e vet janë kontrata aktive pra nuk janë të përfunduara. Rrjedhimisht ato nuk mund të merren parasysh nga AK. Ndërsa sa i përket kontratave që janë të përfunduara, as në këtë rast nuk është kontestues fakti që këto kontrata nuk janë të natyrës së ngjashme (infrastrukturë) prandaj as këto nuk mund të merren parasysh nga AK. Njëkohësisht duhet cekur se AK ka kërkuar edhe sqarime shtesë për parashtruesin mirëpo ky i fundit as përmes sqarimeve shtesë nuk ka arritur që të prezantoj ndonjë dëshmi përmes të cilës do të mund të arrihej te një epilog tjetër.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Prishtinë, 17.10.2025


Kisar SHEHU
Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.